

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-043
Prishtinë, më 12 dhjetor 2008, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, të mbajtur më 12 dhjetor 2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Naim Maloku dhe Sllobodan Petroviq, ndërsa munguan: Nexhat Daci, Ibrahim Gashi dhe Xhezair Murati.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja dhe Mufera Sinik, ndërsa munguan Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Ardian Gjini, Lulzim Zeneli dhe Bojan Stojanoviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Skender Reçica dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Eshref Vishi;

Nga Ambasada amerikane: Bajram Geci;

Nga NDI: Rinor Beka, dhe

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave, dhe
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 dhjetor 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 dhjetor 2008, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për përgatitjet e nevojshme për seancat e ardhshme të Kuvendit.

Ai propozoi që Kuvendi gjatë javës së ardhshme t'i mbajë katër seanca të veçanta. Dy të rregullta dhe dy për shqyrtimin e projektligjeve nga Pakoja e Ahtisarit.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seancat e ardhshme të Kuvendit të mbahen, si vijon:

Më 15 dhjetor 2008, në orën 14:00, me këtë rend dite:

1. Shqyrtimi i parë i Grupit të tetë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt,
- 1.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi,
- 1.3 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
- 1.4 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës,
- 1.5 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, dhe
- 1.6 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Më 16 dhjetor 2008, në orën 14:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i dytë i Grupit të tetë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të huajt,
- 1.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi,
- 1.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
- 1.4 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës,
- 1.5 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, dhe
- 1.6 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Më 18 dhjetor 2008, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat individuale,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për normën e akcizës në Kosovë,
9. Rishqyrtimi i Ligjit për taksën e akomodimit në objektet hoteliere dhe turistike, dhe
10. Shqyrtimi Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave Tatimore.

Më 19 dhjetor 2008, në orën 10:00, me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2009.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Raportit të tremujorit të tretë të vitit 2008 për shpenzimet e Kuvendit të Kosovës

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, i informoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, në hollësi, për shpenzimet e të gjitha vijave buxhetore të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e tretë të vitit 2008.

Kryesia, pasi u informua për shpenzimet buxhetore të tremujorit të tretë, mori këtë

V E N D I M

Miratohet Raporti i tremujorit të tretë të vitit 2008 për shpenzimet e Kuvendit të Kosovës

3.2 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me procedimin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, si dhe të Projekt-Deklaratës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi kishte kërkuar sqarime nga Kryesia e Kuvendit për mosprocedim në seancë plenare të:

1. Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe të
2. Projekt-Deklaratës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia e Kuvendit, së bashku me Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duhet të shikojnë tekstin e Projekt-Deklaratës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë.
2. Të kërkohej nga Qeveria e Kosovës Deklarata Financiare lidhur me implikimet buxhetore për zbatimin Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe të Deklaratës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë.

3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kompensimin e punës së nënkryetarëve të komisioneve parlamentare dhe të deputetëve që janë në dy komisione

Kryesia, pas sqarimeve që paraqiti sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, mori këtë

V E N D I M

Nënkryetarët e komisioneve parlamentare paguhën për punën e tyre në shumën prej 50% Të mëditjes që marrin kryetarët e komisioneve parlamentare, kurse

deputetët që janë të angazhuar në dy komisione parlamentare paguhen në vlerën prej 50% të mëditjes për pjesëmarrje në mbledhjet e komisioneve parlamentare.

3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad hoc për kompensimin e punës për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, vendosi që anëtarët Komisionit ad hoc dhe stafi i tij mbështetës të kompensohen për punën e tyre, sipas vendimit të mëparshëm për pjesëmarrje në punën e komisioneve ad hoc.

3.5 Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesat për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, vendosi si vijon:

- Tre anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa u lejohet udhëtimi zyrtar në Maqedoni prej 11 deri më 13 dhjetor 2008, si dhe pagesën e mëditjeve shtesë, sipas vendimit të mëparshëm të Kryesisë.
- Grupit Joformal të deputetëve të rinj u lejohet udhëtimi zyrtar në Estoni prej 03 deri më 06 dhjetor 2008, si dhe pagesa e mëditjeve shtesë, sipas vendimit të mëparshëm të Kryesisë.
- Anëtarit të Kryesisë i lejohet udhëtimi zyrtar në SHBA prej 02 deri më 7 shkurt 2008, me të gjitha shpenzimet e Kuvendit.

4. Të ndryshme

Slobodan Petroviq, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, ngiti çështjen e pagesës së deputetit Dragan Dimiq.

Kryesia, pasi u informua rreth pagesës së deputetit Dragan Dimiq, për të cilën ai kishte kërkuar që t'i paguhen të ardhurat në mënyrë retroaktive edhe për atë periudhë që ishte pagur një deputetë tjetër, konstatoi se duhet të zbatohet ligji për pagesën e 120 deputetëve njësoj.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale